




REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-0/DPK	N. Prot. Prot. No. 01-3832/12
Nr. llog. Broj stranica 02	Data Datum 24-10-2012



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **27.09.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-02-2405-12, pa konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik, për ztr. *Betim Berisha* – Këshilltar Komunal në Komunën e Drenasit, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e dëshmojnë ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin me numër protokoli AKK-02-2405/12, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pas procedurës së shqyrtimit, kemi konstatuar se nuk ka pasur prova të mjaftueshme që argumentojnë gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari *Betim Berisha* (Këshilltar Komunal në Komunën e Drenasit) nuk ka pozitë menaxhuese as aksione të pronësisë në ndërmarrjen private “Trasing Group” sh.p.k., ashtu siç është dyshuar. Ztr. *Berisha* në takim me zyrtarët e Agjencisë ka dëshmuar se ai është vetëm një nga të punësuarit në këtë ndërmarrje. Po ashtu nga informacionet zyrtare nga ARBK-ja lidhur me këtë biznes, shihet qartë se ky biznes është në pronësi dhe menaxhim të dikujt tjetër, kurse ztr. *Betim Berisha* – Këshilltar Komunal në Komunën e Drenasit, nuk ka kurrfarë pozite vendimarrëse në këtë kompani.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, dhe Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit (Nr.04/L-051) kemi konstatuar se nuk ka situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

